

VENDIM
Nr. 250, datë 12.4.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR KONTRIBUTIN ZVICERAN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË LEZHË DHE SHËNGJIN, PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për kontributin zviceran për financimin e projektit “Furnizimi me ujë dhe kanalizime të ujërave të përdorura në Lezhë dhe Shëngjin, programi i infrastrukturës bashkiake I”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha